



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

### V E N D I M

**K.P.P. 550/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17/08/2018 shqyrtoi ankesën me:

#### **Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Vrana Security Group” dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “Toni Security” shpk, në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt: *“Shërbim i Ruajtjes së Godinave me Roje Private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara* me nr. REF-65350-04-26-2018, me fond limit 3,035,695 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.05.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës.

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, si edhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomikë “Toni Security” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Nazeri 2000” shpk dhe “Vrana Security” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Toni Security” sh.p.k dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. dhe “Vrana Security Group” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit

**Ankimues:**

“Nazeri 2000” sh.p.k.

Adresa: *Rruga “Kavajës” Qendra Condor, kati II  
Tiranë*

“Vrana Security Group” sh.p.k.


Adresa: *Lagjia nr.4 Rruga “Egnatia”  
Durrës*

“Eurogjici Security” shpk

Adresa: *Rruga “Adem Jashari” Lagjia 8 H.10 Ap.3.  
Tiranë*

“Toni Security” shpk

Adresa: *Rruga “Lidhja e Prizërenit” P10/1 kati i parë  
Tiranë*



**Public Health Sector**

**Autoriteti Kontraktor:**

Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës

Adresa: *Lagjia Nr.4, Rr.”Andon .Z.Çajupi  
Durrës*

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## I

### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatorët ekonomik kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

I.3. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomik ankimues.

### *Rrethanat e çështjes*

II. Në datën 27.04.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt: “Shërbim i Ruajtjes së Godinave me Roje Private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të percaktuara” me nr. REF-65350-04-26-2018, me fond limit 3,035,695 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.05.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës.

II.1. Në datën 14.05.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.2. Në datën 18.05.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Eurogjici Security” shpk	2,973,702.2 lekë	kualifikuar;
2. “Toni Security” shpk	2,977,514.4 lekë	skualifikuar;
3. “Nazeri 2000” shpk	2,994,723.2 lekë	kualifikuar;

4. “Vrana Security Group” shpk

2,994,723.2 lekë

kualifikuar;

II.3. Në datën 23.05.2018, operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Vrana Security Group” dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të shoqërisë “Toni Security” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat se: “[...] Së pari nga ana e autoritetit kontraktor duhet të skualifikohet “Eurogjici Security” shpk dhe duhet të shtohen arsyet e skualifikimit për “Toni Security” pasi nuk kanë parashikuar pagën minimale ditore në bazë të VKM nr.399 datë 03.05.2017 dhe në bazë të ligjit nr.75/2014 SHPSF e cila duhej përlllogaritur në vlerën 1183.82 lekë. Nuk kanë parashikuar shtesat për turnin e dytë II për një roje në vlerën 34.29 lekë/dita për një roje. Nuk kanë parashikuar “Shtesën për turnin III” në vlerën 228.6 lekë/dita shtesa turni i tretë. Nuk kanë parashikuar saktë “Shpenzimet për sigurime shoqërore & shëndetësore në masën 16.7 % për një roje në vlerën 16.7 % për një roje në vlerën 241.6. Pra oferta duhej të përlllogaritjen  $1,688.31 \times 3.62$  roje = 6111.68 x 2 vendorje = 12223.36 lekë x 8 muaj ( 245 ditë) = 2,994,723.2 lekë për këto shoqëri kanë ofertuar më pak pra janë nën koston ligjore të lejuar. Së dyti duhet të skualifikohet shoqëria “Eurogjici Security” shpk, “Vrana Security Group” shpk dhe duhet të shtohen arsyet e skualifikimit për “Toni Security” shpk pasi nuk plotësojnë pikën 4 kapaciteti teknik të DST-ve pasi aktin e miratimit të Qendrës së Kontrollit DVP Durrës e kanë të pavlefshëm pasi është jashtë afatit 2 vjeçar sipas Udhëzimit nr.130 datë 06.03.2018 Kreun VII gërma “D” pika 5. Duhet të skualifikohet “Eurogjici Security”, “Vrana Security Group” dhe duhet të shohet arsyet e skualifikimit për Toni Security pasi nuk kanë paraqitur 10 certifikata të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar ( ligji 75/2014 neni 5 pika 5) sipas përcaktimit ligjor pika 3 tek DST.[...]”

II.3.2. Në datën 25.05.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.431/1 prot datë 25.05.2018 i kthen përgjigje palës ankimuese “Nazeri 2000” shpk duke mos pranuar aneksën

II.3.3. Në kthim përgjigje, autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur se “[...] Përsa i përket pretendimit tuaj për përlllogaritjen gabim të ofertave nga operatorët ekonomikë “Eurogjici Security”, “Vrana Security Group” shpk dhe “Toni Security” sqarojmë se oferrat e tyre janë llogaritur në përputhje të plotë me ligjin me DST dhe kërkesat tona sipas shtojcës I dhe nuk janë aspak nën minimumin ligjor. Përsa i përket afatit të Akt Miratimit për Qendrën e Kontrollit, sqarojmë se janë konform ligjit. Në DST është kërkuar të paraqiten certifikata të vlefshme për të paktën 10 punonjës. Të gjithë operatorët pjesëmarrës e kanë plotësuar këtë kriter. [...]”

II.3.4. Në datën 28.05.2018 operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.4. Në datën 23.05.2018, operatori ekonomik ankimues “Vrana Security Group” sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk, dhe duke kërkuar shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “Toni Security” shpk.

II.4.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat se: “[...] Pretendimi jonë i bazur në ligj qëndron në faktin se ofertat e 2 shoqërive të mësipërme përkatësisht “Eurogjici Security” shpk dhe “Toni Security” shpk janë nën koston ligjore të lejuar. Paga bazë e një punonjësi shërbimi është 36000 lekë. Sipas nenit 81 të Kodit të Punës- Shtesat mbi pagë për vështirësi për turnin e 2-të llogaritet në bazë të nenit 81 të ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Çdo orë pune e kryer nga ora 19:00 deri në 22:00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20 %. Nga përlllogaritja e afateve të kontratës na del që: Viti ka gjithësej 365 ditë/12 muaj- 1 muaj ka mesatarisht 30.41 ditë kalendarike. Pra kemi shtesa turni i 2-të  $30.41 \times 3 \times 206.89 \text{ lekë/ora} \times 2 \text{ vendroje} /7.24 \text{ roje} = 1042.79 \text{ lekë}$  shtesa turni 2 për punonjës në muaj. Shtesat mbi pagë për vështirësi për turnin e 3-të llogaritet në bazë të nenit 81 të ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Çdo orë pune e kryer nga ora 22:00 deri në 6:00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 50 %, pra kemi shtesa turni 3-  $30.41 \times 8 \text{ orë} (206.89 \text{ lekë/ora} \times 50 \%) \times 2 \text{ vendroje} /7.24 \text{ roje} = 5841.96 \text{ lekë}$  shtesa turni 3 për punonjës në muaj. Atëherë pagat + shtesat mbi pagë  $t2+t3= 36,000 +1042.79+6951.96=43994.75 \text{ lekë}$ . Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore duke filluar nga data 01.05.2009 e në vazhdim do të jetë 27.9 % e pagës bruto mujore, pjesa e punëdhënësit do të jetë 16.7 %. Pra  $43994.75 \times 16.7 \% = 7347.12 \text{ lekë}$  (sig shoqërore +shëndetësore)  $43994.75+7347.12=51341.87 \text{ lekë}$  në muaj. Shpenzimet operative: Shpenzime për armatim 0.0001. 2. Shpenzimet për ndërlihdje=0.0001 lekë në muaj. 3. Shpenzimet uniform= 0.0001 lekë në muaj. Totali:  $51341.87+0.0001+0.0001+0.0001= 51341.87 \text{ lekë}$  për punonjës në muaj pa TVSH. Fitimi i parashikuar= 0.0001 lekë në muaj. Siç duket të dyja këto shoqëri kanë paraqitur oferta nën minimumin ligjor të lejuar duke shkelur qartazi legjislacionin përkatës dhe urdhërat dhe udhëzimet e Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së ofertave të SHPSF (Rekomandimi datë 01.04.2015 dhe Rekomandimit nr.2511 prot datë 06.02.2017 të APP). Pra mendojmë se ka 2 mundësi, ose shoqëritë kanë bërë gabim aritmetikor ose qartazi me dashje kanë paraqitur oferta nën minimumin ligjor ose vlerësimi është bërë gabim. Autoriteti kontraktor më datë 18.05.2018 u ka dërguar shoqërive të cilat kanë bërë përlllogaritjen me 243.28 ditë një kërkesë për rregullim të këtij lapsusi pasi ky i fundit e ka shprehur në ditë 245. Pjesë e kësaj kërkesë kemi qenë dhe ne si shoqëri, por duket qartazi se dy shoqëritë e sipërpërmendura nuk e kanë paranuar këtë fakt duke i nxjerrë dhe automatikisht me çmim më të ulët. Megjithëse do të duhej të ishin skualifikuar ose

*minimalisht duhej të ishin njësuar me 245 ditë. Bashkëngjitur po ju dërgojmë edhe mesazhin nga autoriteti kontraktor për faktin se autoritetet duhet ti bënin llogaritjet për 245 ditë. [...]*

II.4.2. Në datën 25.05.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.430/1 prot datë 25.05.2018 i kthen përgjigje palës ankimuese “Vrana Security Group” shpk duke mos pranuar ankesën.

II.4.3. Në kthim përgjigje, autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur se “ [...] Përsa i përket pretendimit tuaj për përlllogaritjen gabim të ofertave nga operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” shpk dhe “Toni Security” shpk sqarojmë se ofertat e tyre janë llogaritur në përputhje të plotë me ligjin, me DST dhe kërkesat tona sipas shtojcës 1 dhe nuk janë aspak nën minimumin ligjor. Në përlllogaritjen gabim (lapsusit) të numrit të ditëve të ofrimit të shërbimit keni qenë vetëm ju “Vrana Security Group” të cilët e keni llogaritur gabim këtë numër dhe asnjë prej operatorëve të tjerë pjesëmarrës në këtë tender. [...]”

II.4.4. Në datën 30.05.2018 operatori ekonomik ankimues “Vrana Security Group” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 19.05.2018, operatori ekonomik ankimues “Eurogjici Security” sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk, dhe “Vrana Security” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit.

### Public Health Sector

II.5.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat se: “[...]”

- i. *Ofertat e përlllogaritura nga operatorët ekonomikë “Nazeri 2000” shpk dhe “Vrana Security Group” shpk nuk është hartuar në përputhje me kërkesat të pasqyruara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit pasi oferta e tyre ekonomik janë përlllogaritur për 245 ditë dhe 8 muaj.*
- ii. *Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Librazhd datë 09.12.2015 nuk jep informacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit se për cilin vit janë shlyer detyrimet vendore.*
- iii. *Operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk ka paraqitur vërtetim lëshuar nga Bashkia Durrës nr.66 prot datë 01.03.2017 me anë të cilit nuk jepet informacioni i kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit për vitin përkatës për të cilin janë shlyer taksat vendore por thekson se ka shlyer taksat vendore deri ditën e marrjes së vërtetimit.*
- iv. *Operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk ka paraqitur vërtetim lëshuar nga Bashkia Durrës nr. 124 prot datë 29.04.2017 me anë të të cilit nuk jepet informacioni se operatorët ekonomikë kanë shlyer taksat për vitin 2017.*

- v. Referuar vërtetimit nr. 367 prot datë 12.03.2015 lëshuar nga Bashkia Tiranë për adresën “Qendër Kondor, Kulla H Ap.27” rezulton se ky dokument nuk thekson se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për vitin 2015 por se ka shlyer taskat deri në vitin 2015. Pra nuk ka përmbushur kriteret e veçanta të kualifikimit.
- vi. Nga vërtetimi lëshuar nga Bashkia Tiranë datë 10.08.2016 thekson se janë shlyer taksat vendore për vitin 2016 për adresën “Qendra Kondor Kulla H Ap 27” Ndërkohë për adresën “Qendra Kondor Kati II” vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Tiranë në datën 24.08.2016 nuk vërteton se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për vitin 2016 por thekson se ka shlyer taksat vendore deri në vitin 2016 pra jo për 2016.
- vii. Nga vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Kavajë datë 13.07.2015 nuk jep informacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit se për cilin vit janë shlyer detyrimet vendore.
- viii. Rezulton se kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar në mënyrë eksplicite “Vërtetim lëshuar nga Bashkia/Njësi Administrative me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2015-2016-2017 për adresat ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet operatori ekonomik siaps Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.” Referuar ekstraktit historik të shoqërisë rezulton se në datën 11.09.2015 janë bërë ndryshimet si në vijim: Është shtuar adresa Kukës, lagjia nr. 2 rruga Kosova tek Obelisku..... Është shtuar adresa Kukës Lagjia nr. 6 indeksi i hartës -1-6 Njësi, zona nr.2315 numër pasurie 34/12-N 4. Është hequr adresa Kukës Lagjia nr. 2 Rruga “Kosova” Ndërtesa tek Obelisku kati i parë. Ndërkohë në përmbushje të kriterit referuar sa më sipër operatori ekonomik ka paraqitur: Vërtetim nr. 1842 prot datë 15.10.2015 lëshuar nga Bashkia Kukës me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për aktivitetin në Lagjen nr. 6 për vitin 2015 ( 4 muaj). Vërtetim nr. 657 prot datë 07.03.2016 lëshuar nga Bashkia Kukës me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për vendodhjen e aktivitetit në lagjen nr.6 për vitin 2016. Vërtetim nr.729 prot datë 22.02.2017 lëshuar nga Bashkia Kukës me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për vendodhjen e aktivitetit në lagjen nr. 6 për vitin 2015 ( shtator-nëntor) 2016,2017. Nga sa më sipër del qartë se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vendodhjen e aktivitetit në Lagjia nr.2 Rruga “Kosova”, adresë e cila referuar ekstraktit historik të shoqërisë është shtuar në datën 11.09.2015 dhe është hequr 2.10.2015.
- ix. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit është kërkuar në mënyrë eksplicite “Vërtetim lëshuar nga Bashkia/Njësi Administrative me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2015-2016-2017 për adresat ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet operatori ekonomik siaps Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.” Operatori ekonomik në datën 11.09.2015 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim: Është shtuar adresa “Shkodër” lagjia 3 Heronjtë, Rruga Vau i Dejës, ish rajoni i Policisë Shkodër Ap 167 kati i parë. Në datën 02.10.2015 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim: Është hequr adresa “Shkodër, Lagjia 3 Heronjtë, Rruga Vau i Dejës, ish rajoni i Policisë Shkodër, Ap 167, kati parë. Është

shtuar adresa “Shkodër” Lagjia 3 Heronjtë, Rruga “Bulevard Skënderbej zona 8593 nr.2073. Ndërkohë në përmbushje të kriterit të referuar më sipër operatori ekonomik ka paraqitur: Vërtetim nr. 444 prot datë 13.10.2015 lëshuar nga Bashkia Shkodër me anë të së cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për vendodhjen e aktivitetit me adresë Njësia Administrative nr. 5 Rruga Bulevardi “Skënderbeu” për vitin 2014 dhe 2015. Vërtetim nr.87 prot datë 07.03.2016 lëshuar nga Bashkia Shkodër me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore pranë Bashkisë Shkodër për vitin 2016. Vërtetim nr. 80 prot datë 10.02.2017 lëshuar nga Bashkia Shkodër me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore pranë Bashkisë Shkodër për vitin 2017. Nga sa më sipër del qartë se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vendodhjen e aktivitetit në adresën “Shkodër” Laigjia 3 Heronjtë Rruga “Vau i Dejës, ish Rajoni i Policisë Shkodër, ap 167 kati i parë adresë e cila referuar ekstraktit historik të shoqërisë është shtuar në datën 11.09.2015 dhe është hequr 02.10.2015. Pra asnjë prej vërtetimeve të paraqitur në tender nga operatori ekonomik nuk ka vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2015 për adresën “Shkodër, lagjia 3 heronjtë”.

- x. Referuar kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar në mënyrë eksplicite “Vërtetim lëshuar nga Bashkia/ Njësia Administrative me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2015-2016-2017 për adresat ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet operatori ekonomik siaps Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.” Operatori ekonomik në datën 08.02.2012 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim: Është shtuar adresa Berat Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Berat, Lagjia “30 vjetori”, Në datën 20.02.2014 në ekstraktin historik janë bërë ndryshimet si në vijim: është hequr adresa “Berat”, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Berat, Lagjia “30 vjetori”. Në datën 11.09.2015 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim: është shtuar: Adresa “Berat”, Lagjia 3 Dhjetori. Rr Babdut Karbunara” Godina 1- katëshe, përballë bar kafe Polovina. Ndërkohë në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik ka paraqitur: vërtetim datë 23.09.2015 lëshuar nga Bashkia Berat me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore deri më 31.12.2015. Vërtetim datë 02.03.2016 lëshuar nga Bashkia Berat me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për aktivitetin në adresë “Lagjia 30 Vjetori” për periudhën deri më 31.12.2016. Vërtetim datë 10.02.2017 lëshuar nga Bashkia Berat me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për aktivitetin me adresë “Lagjia 30 vjetori” Rr Babdut Karburanara për periudhën deri më 31.12.2017. Nga sa më sipër rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur një vërtetim për shlyerjen e taksave vendore pranë Bashkisë Berat për adresën “Berat” Lagjia 3 Dhjetori, Rr Babdut Karbunara Godina 1- katëshe përballë bar kafe Polovina
- xi. Referuar kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar në mënyrë eksplicite “Vërtetim lëshuar nga Bashkia/ Njësia Administrative me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2015-2016-2017 për adresat ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet



operatori ekonomik siaps Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.” Operatori ekonomik në datën 28.07.2008 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim: Është shtuar adresa “Krujë, Aeroporti Nënë Tereza” Në datën 08.02.2012 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim: Është shtuar Adresa Krujë Drejtori e Shërbimit Spitalor, “Dr. Stefan Gjoni” Lagjia nr. 1. Në datën 08.01.2013 në ekstraktin historik të shoqërisë janë ëbrë ndryshimet si në vijim : Është hequr adresa :Krujë, Drejtori e Shërbimit Spitalor “Dr. Stefan Gjoni”. Në datën 20.02.2014 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet në vijim : Është hequr adresa: Krujë, Aeroporti Nënë Tereza. Ndërkohë në përmbushje të kriterit të referuar sa më sipër operatori ekonomik ka paraqitur: Vërtetim datë 09.12.2015 lëshuar nga Bashkia Krujë me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për aktivitetin me adresë sekondare “Lagjia nr. 1 nuk ka detyrime për taksat e tarifa vendore pranë Bashkisë Krujë”. Rezulton se vërtetimi datë 09.12.2015 lëshuar nga Bashkia Krujë nuk jep informacion për vitin për të cilin operatori ekonomik nuk ka detyrime.

- xii. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, autoriteti kontraktor ka kërkuar “ Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr.9918 datë 19.05.2018 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zonë mbulimi “Qarkun Durrës”. Periudha e vlefshmërisë së Licencës/Autorizimit duhet të mbulojë periudhën kohore në të cilën është parashikuar të kryet zbatimi i kontratës. Rezulton se operatori nuk ka paraqitur Licencë nga AKEP me zonë mbulimi Qarkun Durrës.
- xiii. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik autoriteti kontraktor ka kërkuar “ Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt- Miratim për Qendrën e Kontrollit në qytetin Durrësit të miratuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës. Rezulton se operatori ekonomik nuk disponon sallë operative në qytetin Durrës dhe nuk ka paraqitur Akt Miratim për Qendrën e Kontrollit në Qytetin e Durrës.
- xiv. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik autoriteti kontraktor ka kërkuar “ Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim lëshuar jo më parë se muaji Janar 2018 lëshuar nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Durrës me anë të se cilës të jepet informacion për: Numrin e punonjësve të shërbimit jo më pak se 10 punonjës shërbimi, listën emërore ku specifikohet data e lëshimit të certifikatave të punonjësve si dhe afati i vlefshmërisë së tyre. Rezulton se lista emërore e paraqitur nga operatori ekonomik nuk shprehet për afatin e vlefshmërisë së certifikatave pra nuk përmbush kriterin kualifikues.
- Operatori ekonomik “Vrana Security Group” të skualifikohet edhe për arsyet si në vijim:
- xv. Vërtetimi nr. 22 prot datë 05.03.2016 lëshuar nga Bashkia Durrës nuk vërteton që janë shlyer detyrimet për gjithë vitin 2015 pasi ky vërtetim përcakton se janë shlyer detyrimet deri në datën 05.03.2015 datë në të cilën është lëshuar ky vërtetim, pra jo gjithë viti kalendarik.

- xvi. *Referuar ekstraktit historik të shoqërisë “Vrana Security Group” në datën 26.03.2015 është shtuar adresa “Durrës, Lagjia 8 Rruga 14 nëntori godina 2 katëshe, kati i parë Zona kadastrale 8512 nr.pasurie 5/270-Nd+1-2” Rezulton se për këtë adresë nuk është paraqitur vërtetim ëlshuar nga Bashkia Durrës me anë të së cilit të vërtetohej pagesa e taksave vendore për vitin 2015.*
- xvii. *Faturat tatimore të paraqitura për kontratat e realizuara janë të pa vulosura nga shitësi. Referuar rubrikave të faturës rezulton se shitësi, përveç emër, mbiemër duhet ta vulosë atë.*
- xviii. *Kontratat e nëshkruara me Spitalin Durrës nuk janë shoqëruar me vërtetim për realizimin me sukses të kontratës që të përmbajë afatin e realizimit, objektin dhe vlerën.*

II.5.2. Në datën 23.05.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.424/1 prot datë 23.05.2018 i kthen përgjigje palës ankimuese “Eurogjici Security” shpk duke mos pranuar ankesën.

II.5.3. Në kthim përgjigje, autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur se “ [...] Përsa i përket pretendimit tuaj për përlllogaritjen gabim të ofertave nga operatorët ekonomikë “Nazeri 2000” shpk dhe “Vrana Security Group” shpk sqarohet se ofertat e tyre janë llogaritur në përputhje të plotë me ligjin, me DST dhe kërkesat tona sipas shtojcës 1. Përsa i përket “Vrana Security Group” shpk shifra e ditëve 243.28 ishte gabim artimetik i cili u pranua nga operatori ekonomik në fjalë mbas kërkesës që ne bëmë elektronikisht në SPE sepse përfundimi ishte i njëjtë për 245 ditë. 2. Përsa i përket vërtetimeve të lëshuara nga Bashkia Lirbazhd e pamë të besueshëm vërtetimin që thotë se nuk ka detyrime për taksa e tarifa vendore. [...]”

II.5.4. Në datën 01.06.2018 operatori ekonomik ankimues “Eurogjici Security” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Operatori ekonomik “Toni Security” shpk është njoftuar me anë të Sistemit të Prokurimeve Elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me arsyetimin se “*paraqitja e një dokumenti të pasaktë nga ana e OE, sipas DST, përben kusht për skualifikim.*”

II.6.1. Në datën 18.05.2018, operatori ekonomik ankimues “Toni Security” sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk, dhe “Vrana Security” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6.2. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij duke ngritur pretendime se referuar arsyes së skualifikimit nuk pasqyrohet se çfarë pasaktësie ka në dokumentacionin e ngarkuar në SPE. Në anksën drejtuar pranë autoritetit kontraktor, ankimuesi parashtron argumente në lidhje me

plotësimin e secilit prej kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pranimimit dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit, dorëzimin e shtojcave dhe të vërtetimit mbi shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë, si edhe mbi plotësimin e kapacitetit ekonomik, financiar ashtu edhe kapacitetit teknik të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës, pala ankimuese ka ngritur pretendimet në mënyrë të përmbledhur se: “[...]

- i. *Operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk dhe “Vrana Security Group” shpk nuk kanë ofertuar për 245 ditë dhe 8 muaj e për këtë duhet të skualifikohen. Autoriteti kontraktor nuk duhet të modifikojë ofertat e këtyre operatorëve duke iu korigjuar afatin pasi nuk jemi në kushtet e gabimeve aritmetike.*

*Operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk të skualifikohet edhe për arsyet si vijon:*

- ii. *Vërtetimi datë 09.12.2015 i lëshuar nga Bashkia Librazhd nuk jep informacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit se për cilin vit janë shlyer detyrimet vendore.*
- iii. *Vërtetim nr. 378 prot datë 15.12.2016 lëshuar nga Bashkia Durrës nuk jep informacionin e duhur dhe të kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit për vitin përkatës për të cilin janë shlyer taksat vendore por thekson se ka shlyer taksat vendore deri ditën e marrjes së vërtetimit.*
- iv. *Vërtetim nr.66 prot datë 01.03.2017 lëshuar nga Bashkia Durrës nuk jep informacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit për vitin përkatës për të cilin janë shlyer taksat vendore por thekson se ka shlyer taksat vendore deri ditën e marrjes së vërtetimit.*
- v. *Vërtetimi nr. 124 prot datë 29.04.2017 lëshuar nga Bashkia Durrës nuk jep informacion se operatori ekonomikë ka shlyer taksat për vitin 2017. Akoma më tej për shoqërinë “Nazeri 2000” shpk ka një precedent për raste të ngjashme, ai është vendimi i Komisionit të Prokurimeve Publike i cili me Vendimin nr.203/2017 datë 07.04.2017 (vendimi gjendet online në faqen elektronike të KPP-së Rubrika Ankesa në Proces) nëpërmjet të cilit KPP ka vendosur të skualifikojë këtë operator ekonomik.*
- vi. *Vërtetimi nr. 367 prot datë 12.03.2015 lëshuar nga Bashkia Tiranë për adresën “Qendër Kondor, Kulla H Ap.27” nuk thekson se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për vitin 2015 por se ka shlyer taskat deri në vitin 2015.*
- vii. *Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Tiranë datë 10.08.2016 konfirmon se janë shlyer taksat vendore për vitin 2016 oër adresën “Qendrër Kondor” Kulla H. Ap 27. Ndërkohë që për adresën “Qendra Kondor Kati II” vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Tiranë në datën 24.08.2016 nuk vërteton se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për vitin 2016 por thekson se ka shlyer taksat vendore deri në vitin 2016.*
- viii. *Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Kavajë datë 13.07.2015 nuk jep informacionin e kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit se për cilin vit janë shlyer detyrimet vendore.*
- ix. *Referuar ekstraktit historik të shoqërisë rezulton se në datën 11.09.2015 janë bërë ndryshimet si në vijim: Është shtuar adresa Kukës, lagjia nr. 2 rruga Kosova tek Obelisku..... Është shtuar adresa Kukës Lagjia nr. 6 indeksi i hartës -1-6 Njësi, zona nr.2315 numër pasurie 34/12- N 4. Është hequr adresa Kukës Lagjia nr. 2 Rruga “Kosova” Ndërtesa tek Obelisku kati i parë. Ndërkohë në pëmbushje të kriterit referuar*

sa më sipër operatori ekonomik disponon: Vërtetim nr. 1842 prot datë 15.10.2015 lëshuar nga Bashkia Kukës me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për aktivitetin në Lagjen nr. 6 për vitin 2015 ( 4 muaj). Vërtetim nr. 657 prot datë 07.03.2016 lëshuar nga Bashkia Kukës me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për vendodhjen e aktivitetit në lagjen nr.6 për vitin 2016. Vërtetim nr. 729 prot datë 22.02.2017 lëshuar nga Bashkia Kukës me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për vendodhjen e aktivitetit në lagjen nr. 6 për vitin 2015 ( shtator-nëntor) 2016,2017. Nga sa më sipër del qartë se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vendodhjen e aktivitetit në Lagjia nr.2 Rruga “Kosova”, Ndërtesa tek Obelisku kati i parë, adresë e cila referuar ekstraktit historik të shoqërisë është shtuar datën 11.09.2015 dhe është hequr 2.10.2015

x. Operatori ekonomik në datën 11.09.2015 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim: Është shtuar adresa “Shkodër” lagjia 3 Heronjtë, Rruga Vau i Dejës, ish rajoni i Policisë Shkodër Ap 167 kati i parë. Në datën 02.10.2015 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim: Është hequr adresa “Shkodër, Lagjia 3 Heronjtë, Rruga Vau i Dejës, ish rajoni i Policisë Shkodër, Ap 167, kati parë. Është shtuar adresa “Shkodër” Lagjia 3 Heronjtë, Rruga “Bulevard Skënderbej zona 8593 nr.2073. Ndërkohë në përmbushje të kriterit të referuar më sipër operatori ekonomik ka paraqitur: Vërtetim nr. 444 prot datë 13.10.2015 lëshuar nga Bashkia Shkodër me anë të së cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për vendodhjen e aktivitetit me adresë Njësia Administrative nr. 5 Rruga Bulevardi “Skënderbeu” për vitin 2014 dhe 2015. Vërtetim nr.87 prot datë 07.03.2016 lëshuar nga Bashkia Shkodër me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore pranë Bashkisë Shkodër për vitin 2016. Vërtetim nr. 80 prot datë 10.02.2017 lëshuar nga Bashkia Shkodër me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore pranë Bashkisë Shkodër për vitin 2017. Nga sa më sipër del qartë se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vendodhjen e aktivitetit në adresën “Shkodër” Laigjia 3 Heronjtë Rruga “Vau i Dejës, ish Rajoni i Policisë Shkodër, ap 167 kati i parë adresë e cila referuar ekstraktit historik të shoqërisë është shtuar në datën 11.09.2015 dhe është hequr 02.10.2015. Pra asnjë prej vërtetimeve të paraqitura në tender nga operatori ekonomik nuk ka vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2015 për adresën “Shkodër, lagjia 3 heronjtë”rruga Vau i Dejës, ish Rajoni i Policisë Shkdër ap 167, kati i parë.

xi. Operatori ekonomik në datën 08.02.2012 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim: Është shtuar adresa Berat Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Berat, Lagjia “30 vjetori”, Në datën 20.02.2014 në ekstraktin histroik janë bërë ndryshimet si në vijim: është hequr adresa “Berat”, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Berat, Lagjia “30 vjetori”. Në datën 11.09.2015 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim: është shtuar: Adresa “Berat”, Lagjia 3 Dhjetori. Rr Babdut

Karburnara” Godina 1- katëshe, përballë bar kafe Polovina. Ndërkohë në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik ka paraqitur: Vërtetim datë 23.09.2015 lëshuar nga Bashkia Berat me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore deri më 31.12.2015. Vërtetim datë 02.03.2016 lëshuar nga Bashkia Berat me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për aktivitetin në adresë “Lagjia 30 Vjetori” për periudhën deri më 31.12.2016. Vërtetim datë 10.02.2017 lëshuar nga Bashkia Berat me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për aktivitetin me adresë “Lagjia 30 vjetori” Rr Babdud Karburnara për periudhën deri më 31.12.2017. Nga sa më sipër rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur një vërtetim për shlyerjen e taksave vendore pranë Bashkisë Berat për adresën “Berat” Lagjia 3 Dhjetori, Rr Babdud Karburnara Godina 1- katëshe përballë bar kafe Polovina.

- xii. Operatori ekonomik në datën 28.07.2008 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim: Është shtuar adresa “Krujë, Aeroporti Nënë Tereza” Në datën 08.02.2012 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim: Është shtuar Adresa Krijë Drejtoria e Shërbimit Spitalor, “Dr Stefan Gjoni” Lagjia nr. 1. Në datën 08.01.2013 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet si në vijim : Është hequr adresa :Krujë, Drejtoria e Shërbimit Spitalor “Dr. Stefan Gjoni”. Në datën 20.02.2014 në ekstraktin historik të shoqërisë janë bërë ndryshimet në vijim : Është hequr adresa: Krujë, Aeroporti Nënë Tereza. Ndërkohë në përmbushje të kriterit të referuar sa më sipër operatori ekonomik ka paraqitur: Vërtetim datë 09.12.2015 lëshuar nga Bashkia Krujë me anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik ka shlyer taksat vendore për aktivitetin me adresë sekondare “Lagjia nr. 1 nuk ka detyrime për taksat e tarifa vendore pranë Bashkisë Krujë”. Rezulton se vërtetimi datë 09.12.2015 lëshuar nga Bashkia Krujë nuk jep informacion për vitin për të cilin operatori ekonomik nuk ka detyrime.
- xiii. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, autoriteti kontraktor ka kërkuar “ Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr.9918 datë 19.05.2018 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zonë mbulimi “Qarkun Durrës”. Periudha e vlefshmërisë së Licencës/Autorizimit duhet të mbulojë periudhën kohore në të cilën është parashikuar të kryet zbatimi i kontratës. Rezulton se operatori disponon Licencë nga AKEP nr. 842 datë 20.07.2009 me zonë mbulimi rrethin Durrës dhe jo Qarkun Durrës.
- xiv. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik autoriteti kontraktor ka kërkuar “ Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt- Miratim për Qendrën e Kontrollit në qytetin Durrësit të miratuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës.” Rezulton se operatori ekonomik nuk disponon sallë operative në qytetin Durrës dhe nuk ka paraqitur Akt Miratim për Qendrën e Kontrollit në Qytetin e Durrës.

Operatori ekonomik “Vrana Security Group” të skualifikohet edhe për arsyet si në vijim:

- xv. Vërtetimi nr. 22 prot datë 05.03.2016 lëshuar nga Bashkia Durrës nuk vërteton që janë shlyer detyrimet për gjithë vitin 2015 pasi ky vërtetim përcakton se janë shlyer detyrimet deri në datën 05.03.2015 datë në të cilën është lëshuar ky vërtetim, pra jo gjithë viti kalendarik 2015.
- xvi. Referuar ekstraktit historik të shoqërisë “Vrana Security Group” në datën 26.03.2015 është shtuar adresa “Durrës, Lagjia 8 Rruga 14 nëntori godina 2 katëshe, kati i parë Zona kadastrale 8512 nr.pasurie 5/270-Nd+1-2” Rezulton se për këtë adresë nuk është paraqitur vërtetim lëshuar nga Bashkia Durrës me anë të së cilit të vërtetohej pagesa e taksave vendore për vitin 2015 në respekt dhe përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit edhe me anë të dokumentacionit të dorëzuar në rastin konkret për shlyerjen e detyrimeve për Bashkinë Durrës, në vërtetimin e vitit 2015, vërtetohet vetëm shlyerja e detyrimeve për një nga vendet e ushtrimit të aktivitetit tregëtar.
- xvii. Faturat tatimore të paraqitura për kontratat e realizuara janë të pa vulosura nga shitësi. Referuar rubrikave të faturës rezulton se shitësi, përveç emër, mbiemër duhet ta vulosë atë.
- xviii. Kontratat e nëshkruara me Spitalin Durrës nuk janë shoqëruar me vërtetim për realizimin me sukses të kontratës që të përmbajë afatin e realizimit, objektin dhe vlerën.[...]”

II.6.3. Në datën 23.05.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.423/1 prot datë 23.05.2018 i kthen përgjigje palës ankimuese “Toni Security” shpk duke mos pranuar ankesën.

II.6.4. Në kthim përgjigje, autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur se “ [...] Përsa i përket paqartësisë tuaj për arsyen e skualifikimit ju shpjegojmë se: Skualifikimi erdhi si pasojë e dorëzimit të Vërtetimit të OSHEE të pasaktë. Vërtetimi që keni dorëzuar është vërtetim kolektiv, themi kolektiv pasi nuk është vetëm për “Toni Security” por edhe për “Eurogjici Security”. Ne nuk e kuptojmë se për cilin operator bëhet fjalë. Pra nuk keni detyrime ju “Toni Security” apo nuk ka detyrime “Eurogjici Security”. Për sa më sipër themi që vërtetim është i pasaktë. Përsa i përket pretendimit tuaj për përlllogaritjen gabim të ofertave nga operatorët ekonomikë “Nazeri 2000” shpk dhe “Vrana Security Group” shpk sqarojmë se oferrat e tyre janë llogaritur në përputhje të plotë me ligjin, me DST dhe kërkesat tona sipas shtojcës 1. Përsa i përket “Vrana Security Group” shpk shifra e ditëve 243.28 ishte gabim artimetik i cili u pranua nga operatori ekonomik në fjalë mbas kërkesës që ne bëmë elektronikisht në SPE sepse përfundimi ishte i njëjtë për 245 ditë. Përsa i përket vërtetimeve të lëshuara nga Bashkia Lirbazhd e pamë të besueshëm vërtetimin që thotë se nuk ka detyrime për taksa e tarifa vendore. [...]”

II.6.5. Në datën 01.06.2018 operatori ekonomik ankimues “Toni Security” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.6.6. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrative, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit rezulton se në datën 29.05.2018 operatori ekonomik ankimues “Toni Security” shpk ka paraqitur sërish ankesë pranë autoritetit kontraktor duke arsyetuar në lidhje me arsylene e tij të skualifikimit si edhe duke parashtruar edhe një herë pretendimet e ngritura në ankesën e datës 18.05.2018. Në ankesën e dorëzuar ankimuesi ngre pretendimet në mënyrë të përmbledhur se: “ Duke qenë të paqartë mbi arsyet e skualifikimit i jemi drejtuar me shkresë datë 18.05.2018 autoritetit kontraktor, Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Durrës për të na sqaruar arsyet e skualifikimit. Me shkresë nr.423/1 prot datë 23.05.2018 “Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës” na ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: : Skualifikimi erdhi si pasojë e dorëzimit të Vërtetimit të OSHEE të pasaktë. Vërtetimi që keni dorëzuar është vërtetim kolektiv, themi kolektiv pasi nuk është vetëm për “Toni Security” por edhe për “Eurogjici Security”. Ne nuk e kuptojmë se për cilin operator bëhet fjalë. Pra nuk keni detyrime ju “Toni Security” apo nuk ka detyrime “Eurogjic Security”. Për sa më sipër themi që vërtetim është i pasaktë.” Janë plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor “Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Në nenin 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht “Operatorët ekonomikë për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jo diskriminuese” Në ligji nr. 9643 datë datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 53 pika 3 përcakton që: Autoriteti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. Nga sa më sipër, me qëllim përmbushjen e kriterëve të përcaktuar nga autoriteti kontraktor kemi shkarkuar të gjitha dokumentat e nevojshme në sistemin elektronik të Prokurimeve Publik duke përfshirë edhe kriterin “Vërtetim për OSHEE për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike të muajve të fundit”. Në përmbushje të kriterit, shoqëria jonë ka ngarkuar në SPE vërtetimin si në vijim... Në dokumentin lëshuar OSHEE dhe të ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve publike thuhet se: “Bazuar në deklaratimet e deklaruesit z. Nazmi Kurti vëtojmë se kërkuesi “Toni Security” verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit për kontratën/kontratën me Kod TRIB XXXXXXXXX61, DUOAXXXXXXXX35, Sh2AXXXXXXX23 titullar i të cilës është “Toni Security” shpk dhe “Eurogjici Security” shpk rezulton të ketë në total 0 lekë për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 19.04.2018 duke përfshirë faturën koherente të muajt Mars 2018. Vërtetimi lëshohet me kërkesën e “Toni Security” në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik” dhe jo më vonë se pesë ditë nga data e depozitimit të kësaj kërkesë.” Nga sa më sipër në mënyrë eksplicite OSHEE thekson se “Vërtetimi lëshohet me kërkesë të “Toni Security” dhe në kushtet kur nga sa

*më sipër ky subjekt rezulton me 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike si dhe në mbështetje të pikës 3 të nenit 53 të ligjit nr.9643 ku përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor,në zbatim të pikës 4 të këtij neni vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentin e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji” operatori ynë duhet të ishte kualifikuar.[...]”*

II.6.7. Në datën 13.06.2018 operatori ekonomik ankimues “Toni Security” shpk ka paraqitur sërish ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor datë 29.05.2018.

II.7. Në datën 11.06.2018 me anë të shkresës nr.461/1 protokollit datë 11.06.2018, dhe nr. 490/1 protokollit datë 18.06.2018, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

Pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashëkngjitur, dokumentave të dërguar nga autoriteti kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Toni Security” shpk për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se *“paraqitja e një dokumenti të pasaktë nga ana e OE, sipas DST, përben kusht për skualifikim”* dhe mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Nazeri 2000” shpk dhe “Vrana Security Group” shpk, si edhe mbi pretendimin e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Nazeri 2000” shpk dhe “Vrana Security Group” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 63 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar parashikohet se: *“1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.1.2. Parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitimit në një



procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*.

III.1.3. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.1.4. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrative KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues “Toni Security” shpk ka paraqitur ankim duke kundërshtuar skulifikimin e ofertës së tij si edhe duke kundërshtuar kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë me vlerë oferte më të lartë se ankimuesi. Ndërkohë, KPP konstaton se operatori ekonomik “Toni Security” shpk nuk ka parashtruar pretendime në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik me vlerë më të ulët se oferta e tij. Sa më sipër, edhe në hipotezën e trajtimit lidhur me arsyet e skualifikimit të vetë operatorit ekonomik “Toni Security” shpk, sërish ankimuesi nuk e arrin interesin e tij të ligjshëm. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se oferta ekonomike e operatorëve ekonomikë ankimues “Eurogjici Security” shpk dhe “Toni Security” shpk është më e ulët se sa e operatorëve ekonomikë për të cilët parashtrohen pretendime “Nazeri 2000” shpk dhe “Vrana Security Group” shpk dhe si e tillë cilido qoftë fati i pretendimeve të tyre, nuk çënon interesin e ankimesit, duke mos patur rezikun e një dëmi real ose potencial të tyre nga vendimarrja e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër operatorët ekonomikë nuk legjitohem për pretendimet e mësipërme.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk dhe “Vrana Security” shpk për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomikë “Eurogjici Security” shpk me pretendimin se oferta e dorëzuar është nën minimumin ligjor të lejuar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që

autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.2.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.2.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.2.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta.

Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomiko – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përllogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.2.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përllogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimues duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.2.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.*

*2. Ofertuesit ose kandidatit mund t'i kërkohet të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.*

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.2.8. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikohet si më poshtë:

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>		<i>4</i>	<i>5</i>
<i>Nr</i>	<i>Përshkrimi i Shërbimeve</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi Njësi /dite</i>	<i>Afati i perlllogaritur ne dite</i>
<i>1</i>	<i>Shpenzime per sherbimin e DRSH Durres per 1 vend</i>	<i>dite</i>	<i>1</i>		

	<i>roje me 2 turne</i>				
2	<i>Shpenzime per sherbimin e DRSH Durres per 2 vend roje me 2 turne</i>				
	<i>Çmimi Neto</i>				
	<i>TVSH (%)</i>				
	<i>Çmimi Total</i>				

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Sqarime:

1. Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore etj, per sherbimin e ruajtjes ne 1 vend roje me dy turne.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 2 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e **kostos ditore** të kryerjes së shërbimit.  
Preventiv te kostos per 1 roje ne dite per 1 vendroje

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera (Lek) 1 roje /dite</b>	<b>Vlera (Lek) Ivendroje me dy turne /dite</b>
1	<i>Shpenzime për pagë bazë</i>		
2	<i>Shtesë mbi pagë për turnin II</i>		
3	<i>Shtesë mbi pagë për turnin III</i>		
4	<i>Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%</i>		

5	<i>Fitimi i shoqerise</i>		
	<i>Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite</i>		
	<i>Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite</i>		

- *Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".*
- *Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për 1 vëndroje me dy turne është 3.62 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).*
- *Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit dhe analizës së kostos, rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.*
- *Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek ( e kërkuar në dokumentat e tenderit ) [...]"*

III.2.9. Në shtojcën 10 "Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

### Public Health Sector

*Shërbim i Ruajtjes së Godinave me Roje Private" – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 8 muaj.*

Afatet e ekzekutimit: 8 (tete) muaj ( i parashikuar)

Vendndodhja e shërbimit: \_\_\_\_\_

Numri i Vëndrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve të nevojshme	Afati i levrimit
2	2(per ditët e punës)  3(per dite të diela	7.24	8 muaj  <i>Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas</i>

	dhe festa)		<i>përcaktimit të AK me afat perfundimtar 8 muaj.</i>
--	------------	--	---

[...]"

III.2.10. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ka kërkuar shprehimisht se të gjithë ofertuesit, në ofertën e tyre ekonomike, duhet të parashikojnë të gjitha detyrimet ligjore për kryerjen e këtij shërbimi; pra më konkretisht ofertuesit duhet të përllogarisin pagën bazë minimale ligjore në vlerën prej 36.000 lekë, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%. Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur nga ankimuesit, dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës së operatorit ekonomik “Eurogjici Security” dhe konkretisht elementëve bazë (pagë bazë, shtesa mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%) –elementë këta të cilat janë përcaktuar shprehimisht dhe në DST-; Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Eurogjici Security” shpk, konstaton se nuk ka respektuar dispozitat ligjore lidhur me pagën minimale shtesat për turnin e dytë dhe të tretë si edhe për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Komisioni sqaron se ka qënë detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur nga secili prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga AK me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Në rastin në fjalë, nga oferta e paraqitur nga operatori ekonomik nuk shqyrtohet plotësimi i elementëve bazë të ofertës sipas zërave të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorëve ekonomikë qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomikë ankimues “Nazeri 2000” shpk për shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorëve ekonomik “Eurogjici Security” shpk dhe “Toni Security” shpk, si edhe të operatorit ekonomik “Vrana Security Group” shpk mbi shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “Toni Security” shpk me pretendimin se oferta e dorëzuar është nën minimumin ligjor të lejuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që gjendja faktike juridike e operatorëve ekonomikë “Toni Security” shpk dhe “Eurogjici



Security” shpk mbetet e skualifikuar referuar vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik dhe shqyrtimi në themel i pretendimeve të mësipërme nuk do të ndryshonte gjendjen faktike juridike të këtyre operatorëve ekonomikë e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim nga Komisioni në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Sa më sipër pretendimi i ankimesve nuk merret në shqyrtim.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Vrana Security Group” shpk me pretendimin se: *“nuk plotësojnë pikën 4 kapaciteti teknik të DST-ve pasi aktin e miratimit të Qendrës së Kontrollit DVP Durrës e kanë të pavlefshëm pasi është jashtë afatit 2 vjeçar sipas Udhëzimit nr.130 datë 06.03.2018 Kreun VII gërma “D” pika 5.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 8 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”* të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar se *“2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt-Miratim per Qendren e kontrollit ne qytetin e Durrësit te miratuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut Durrës.”*

III.4.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Vrana Security Group” shpk ka dorëzuar:

- Akt Miratimi për Qendrën e Kontrollit të SHPSF nr.01 protokollit datë 21.07.2015 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë së Shtetit me anë të së cilës vërtetohet se: *“Subjekti “Vrana S” Nr. NIPT: K52214509N Adresa e Qendrës së Kontrollit “ Bazuar në kërkesën e nenit 22 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe Kapitulli VI, gërma “B” dhe “C” të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.157 datë 01.04.2015 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike “ Qendra e Kontrollit të Subjektit “SHPSF “Vrana S” nënkategoria I.3.A gjendet e përshtatshme për të kryer detyrën e drejtimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike.”*
- Vërtetim “Për pjesëmarrje në tender” për subjektin “Vrana Security Group lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës nr. 11 protokollit datë 17.01.2018 ku ndër të tjera konstatohet se *“Me Vendimin nr. 01 datë 21.07.2015 të D.V.P është miratuar Qendra e Kontrollit të Shërbimeve ( Q.K.Sh) në selin qëndrorë Durrës.*

III.4.3. Në nenin 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar prashikohet se *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorhet dhe jodiskriminuese”*

Në nenin 53 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.4.4. Në nenin 22 të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikohet se: “1. Subjekti i licencuar për aktivitetin e shërbimit privat të sigurisë fizike, në çdo njësi administrative që ushtron veprimtari, duhet të ketë qendër kontrolli, ku të tregohet adresa e saj fizike dhe elektronike, si dhe stema me emërtimin e shoqërisë. 2. Qendra e kontrollit të shërbimit kryen detyrat e drejtimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike. 3. Qendra e kontrollit duhet të jetë e pajisur me mjetet e ndërlidhjes, komunikimit e vëzhgimit dhe të veprojë 24 orë në ditë”

III.4.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.6. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në Akt Miratimi për Qendrën e Kontrollit të SHPSF nr.01 protokollit datë 21.07.2015 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë së Shtetit me anë të së cilës vërtetohet se: Subjekti “Vrana S” Nr. NIPT: K52214509N Adresa e Qendrës së Kontrollit “ Bazuar në kërkesën e nenit 22 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe Kapitulli VI, gërma “B” dhe “C” të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.157 datë 01.04.2015 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike “ Qendra e Kontrollit të Subjektit “SHPSF “Vrana S” nënkategoria I.3.A gjendet e përshtatshme për të kryer detyrën e drejtimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike.” Akti i mësipërm është lëshuar në zbatim të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” si edhe aktit nënligjor në fuqi në kohën e lëshimit të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.157 datë 01.04.2015 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike” ( i shfuqizuar) .

III.4.7. Në Udhëzimin Nr. 157, datë 1.4.2015 të Ministrit të Brendshëm “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” Kapitulli VI, gërma “B” dhe “C” parashikohet se:

1. Shoqëritë private të sigurisë fizike që ushtrojnë aktivitet në një ose disa njësi administrative duhet të kenë qendër kontrolli në çdo njësi administrative, ku të tregohet adresa fizike dhe elektronike, si dhe stema e shoqërisë.

2. Subjektet e SHPSF-ve që ushtrojnë veprimtarinë në disa njësi administrative, duhet të kenë qendër kontrolli me sistem ndërlidhjeje dhe marrje të sinjaleve të alarmit dhe sinjalit video në çdo njësi administrative.

3. Subjektet e licencuara për shërbimin privat të sigurisë fizike janë të detyruara të përdorin mjete dhe pajisje elektronike në veprimtarinë e sigurisë fizike.

4. Qendra e kontrollit të jetë e pajisur me sistem ndërlidhës e radiokomunikim dhe radioalarm, të cilat bëjnë të mundur marrjen në kohë të sinjaleve të alarmit dhe sigurimin e pandërprerë të radiondërlidhjes pranë çdo objekti në ruajtje.

5. Serveri bazë të jetë i pajisur me qendrën multifunksionale ku të ketë sistemin bazë të marrjes, përpunimit dhe ruajtjes së sinjaleve të alarmit, të marrjes dhe administrimit të të dhënave, në të gjitha rrugët e sigurimit, radio, GPS-GPRS, GPRS, ADSL dhe ruajtjes së sinjalit video.

6. Subjekti i shërbimit privat të sigurisë fizike duhet të pajiset nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) me autorizim individual.

7. Miratimi i qendrës së kontrollit të SHPSF-ve bëhet me komision nga sektori i rendit publik i Drejtorisë së Policisë Vendore. Në aktin e miratimit bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve të mëposhtme.

#### C. Organizimi i shërbimit në qendrën e kontrollit

1. Qendra e kontrollit kryen detyra për drejtimin, menaxhimin dhe kontrollin e dinamikës të SHPSF- së, për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve publike dhe private, të personave, si dhe veprimtarive social-kulturore sportive fetare e politike dhe sigurimin e vlerave monetare dhe sendeve të çmuara gjatë transportit.

2. Për verifikimin e sinjaleve të alarmit të SHPSF-së organizojnë shërbim me grupe shërbimi të pajisur me armatim, me mjete speciale për ndërhyrje në raste emergjence, si dhe automjete, motorë për lëvizjen e tyre.

3. Qendra e kontrollit vendoset në ambientet e SHPSF-së dhe të ofrojë kapacitetin dhe potencialin e duhur teknik për realizimin e veprimtarisë të ruajtjes dhe sigurisë fizike. Çdo subjekt i SHPSF-së duhet të ketë në administrim qendrën e tij të kontrollit (pronësi/qira) në çdo njësi administrative që ushtron aktivitetin e saj.

4. Qendra e kontrollit realizon monitorimin me anë të sistemit të kamerave të cilësisë së lartë, gjurmimin dhe lokalizimi në kohë reale të automjeteve nëpërmjet sistemit GPS/GPRS, si dhe marrja dhe verifikimi i sinjaleve të alarmit (sinjal grabitje, sinjal zjarri) nëpërmjet mënyrave të ndryshme, si:

a) nëpërmjet telefonit celular (GSM);

b) nëpërmjet telefonit fiks (Contact ID);

c) nëpërmjet rrugëve valore (radio).

5. Detyrat e punonjësit të shërbimit (operatorit) të SHPSF-së:

a) rregulloren e funksionimit të shërbimit në sallën operative;

b) librin e instruktazhit me pjesë (ekstrat) nga aktet normative;

c) evidencën e regjistrimit të sinjaleve të alarmit;

ç) librin e shënimeve;

d) numërorin telefonik të drejtuesve të shoqërisë, të punonjësve të shërbimit sipas objekteve, të titullarëve të subjekteve që shoqëria ka lidhur kontrata dhe të shërbimeve të urgjencës dhe të sallave operative të Policisë së Shtetit;

dh) librin e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit;

e) evidenca e regjistrimit të bisedave telefonike me celularë;

ë) kasafortë metalike për mbajtjen e armatimit dhe pajisjeve speciale;

f) shërbimi në qendrën e kontrollit kryhet nga punonjësi i shërbimit (operatori ) 24 orë në 24.

6. Pajisjet e qendrës së kontrollit dhe të dhënat e siguruara nga përdorimi i tyre vihen në dispozicion sa herë që kërkohet nga Policia e Shtetit, organet e prokurorisë, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

III.4.8. Me anë të Udhëzimit Nr. 308 datë 22.5.2017 të Ministrit të Brendshëm “Për Funkzionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të Shpsf-së” u shfuqizua Udhëzimi Nr. 157, datë 1.4.2015 të Ministrit të Brendshëm “Për Funkzionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”.

Në kreun VI Mjetet, pajisjet e shërbimit dhe Qendra e Kontrollit të SHPSF-ve gërma “B” pika 6 të Udhëzimit Nr. 308 datë 22.5.2017 të Ministrit të Brendshëm “Për Funkzionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të Shpsf-Së” parashikohet se “ Miratimi i Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet me komision nga Sektori i Rendit Publik në Drejtorinë Vendore të Policisë, me afat 4 vjet, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në aktin e miratimit, bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve.”

III.4.9. Me anë të Udhëzimit Nr. 130, datë 5.3.2018 të Ministrit të Brendshëm “ Për Funkzionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” u shfuqizua Udhëzimi nr Nr. 308 datë 22.5.2017 të Ministrit të Brendshëm “Për Funkzionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të Shpsf-Së”

Në kreun VII “Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit Të Shpsf-së” gërma “C” të Udhëzimit Nr. 130, datë 5.3.2018 të Ministrit të Brendshëm “ Për Funkzionimin E Shërbimit Privat Të Sigurisë Fizike” parashikohej se “ 5. Miratimi i Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet nga drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, bazuar në vendimin e KSHKC-së, në çdo dy vjet, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në aktin e miratimit bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve”

Gjithashtu në Kreun IX “ Dispozitat Përfundimtare ” pika 6 të Udhëzimit Nr. 130, datë 5.3.2018 të Ministrit të Brendshëm “ Për Funkzionimin e Shërbimit Privat Të Sigurisë Fizike” parashikohet se “6. Aktet e nxjerra në zbatim të udhëzimit nr. 308, datë 22.5.2017, të ministrit të Punëve të Brendshme, “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së”, mbeten në fuqi”

III.4.10. Gjithashtu, për një shqyrtim të drejtë të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes, në datën 21.06.2018 me anë të shkresës nr.854/3 protokollit datë 21.06.2018, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit duke i kërkuar informacion në lidhje me vlefshmërinë e Akt Miratimi për Qendrën e Kontrollit të lëshuara sipas Udhëzimeve të Ministrit të Brendshëm nr.157 datë 01.04.2015 dhe nr.308 datë 22.05.2017.

III.4.11. Në datën 04.07.2018 me anë të shkresës nr. 4986/2 protokollit datë 04.07.2018 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Në kthim përgjigje ndër të tjera Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ndër të tjera sqaron se: *“..... Aktet e Miratimit për Qendrat e Kontrollit të SHPSF-ve të miratuara në zbatim të Udhëzimeve të Ministrit të Brendshëm nr.157 datë 01.04.2015 dhe nr.308 datë 22.05.2017 kanë qenë pa afat. Këto akte do të konsiderohen të vlefshme deri në momentin e kryejres së procedurave të miratimit apo refuzimit nga Drejtoritë Vendore të Policisë në zbatim të kërkesave të Udhëzimit Ministrit të Brendshëm nr.130 datë 05.03.2018.”*

III.4.12. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar ligjit nr. 75/2014 *“Për shërbimin privat të sigurisë fizike”* vlefshmëria e certifikimit të Qendrës së Kontrollit nuk është e kufizua në kohë (afat ligjor). Rregullimi i mëtejshëm i procedurës, mënyrës dhe afateve të vlefshmërisë së certifikimit rregullohet nga akti nënligjor në zbatim të ligjit. Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se subjekti “Vrana Security Group” shpk ka miratuar Qendrën e Kontrollit me anë të Akt Miratimi për Qendrën e Kontrollit të SHPSF nr.01 protokollit datë 21.07.2015, akt miratim i lëshuar në zbatim të Udhëzimit Nr. 157, datë 1.4.2015 të Ministrit të Brendshëm *“Për Funkzionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”*. Referuar Udhëzimit në fuqi në kohën e lëshimit të Akt Miratimit, KPP konstaton se nuk parashikohej afat vlefshmërie në lidhje me Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit, SHPSF. Gjithashtu, Udhëzimi pasardhës Nr. 308 datë 22.5.2017 të Ministrit të Brendshëm *“Për Funkzionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të Shpsf-Së”* me anë të të cilit u shfuqizua Udhëzimi Nr. 157, datë 1.4.2015 të Ministrit të Brendshëm *“Për Funkzionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”* parashikon afat vlefshmërie 4 vjeçar, dhe nuk shfuqizoi aktet e nxjerra sipas udhëzimit paraardhës, ndërsa Udhëzimi aktual në fuqi parashikon afat vlefshmërie 2 vjeçar në lidhje me Akt Miratimin e Qendrës së Kontrollit dhe nuk shfuqizoi aktet e nxjerra sipas udhëzimit paraardhës. KPP gjykon se marrëdhënia juridike rregullohet nga ligji/akti nënligjor në fuqi në momentin e krijimit të saj.

III.4.13. Gjithashtu, KPP konstaton se në Vërtetim *“Për pjesëmarrje në tender”* për subjektin “Vrana Security Group” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës nr. 11 protokollit datë 17.01.2018 ku ndër të tjera konstatohet se *“Me Vendimin nr. 01 datë 21.07.2015 të D.V.P është miratuar Qendra e Kontrollit të Shërbimeve ( Q.K.Sh) në selin qendrorë Durrës.”* i njëjti akt miratim me atë të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. Gjithashtu, në rastin konkret, referuar trajtimit të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme

e Policisë së Shtetit ka sqaruar se: *“Aktet e Miratimit për Qendrat e Kontrollit të SHPSF-ve të miratuara në zbatim të Udhëzimeve të Ministrisë të Brendshme nr.157 datë 01.04.2015 dhe nr.308 datë 22.05.2017 kanë qenë pa afat. Këto akte do të konsiderohen të vlefshme deri në momentin e kryejres së procedurave të miratimit apo refuzimit nga Drejtoritë Vendore të Policisë në zbatim të kërkesave të Udhëzimit Ministrisë të Brendshme nr.130 datë 05.03.2018.”*

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik *“Nazeri 2000”* shpk për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik *“pasi nuk kanë paraqitur 10 certifikata të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar ( ligji 75/2014 neni 5 pika 5) sipas përcaktimit ligjor pika 3 tek DST”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 8 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”* të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar se *“Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 10 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Durrës*

III.5.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se operatori ekonomik *“Vrana Security Group”* sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresë nr. 11/1 Protokoll., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, *Lista e emërore e punonjësve të subjektit “Vrana Security Group” nënkategoria I.3.A.* me gjithësej 86 punonjës të certifikuar
- Certifikata të punonjësve të shërbimit për ruajtjen dhe sigurinë fizike, lëshuar nga DVP Durrës.

II.5.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.5.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet*

kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.5.5. Neni 5 i Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikon shprehimisht se: *1. Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. 2. Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut. 3. Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së. 4. Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësën e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimin të formularit të kërkesës për aplikim. 5. Certifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësën e shërbimit.*

III.5.6. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”.

III.5.7. Në rekomandimin e përbashkët ndërmjet Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike”, i datës 20.12.2017, publikuar në faqen zyrtare të KPP, në pikën 2, paragrafi 7, është parashikuar shprehimisht: “Në lidhje me hartimin e kriterit për paraqitjen e certifikatave të punonjësve të shërbimit, në kushtet kur, procesi i ricertifikimit të punonjësve të shërbimit nuk ka përfunduar ende dhe është në proces për një afat të pacaktuar, kjo sipas informacionit të dhënë nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, autoritetet kontraktore rekomandohen si më poshtë vijon: Në rastet kur, në dokumentat e tenderit do të kërkohet paraqitja e certifikatave të punonjësve të shërbimit, së bashku me këtë kriter rekomandojmë që, të kërkohet edhe paraqitja e një vërtetimi

të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore, i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar, dhe vlefshmërinë e këtyre certifikatave, datën e certifikimit (datën e lëshimit), si dhe afatin e vlefshmërisë së kësaj certifikate.”

III.5.8. Në korrespondencën e Komisionit të Prokurimit Publik me Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në lidhje me vlefshmërinë e certifikatave, kjo e fundit citon se: “Cilësimi i (vlefshëm) në vërtetimet e performancave për punonjës të certifikuar të cilëve sipas ligjit aktual i ka përfunduar afati 4 vjeçar, është bërë për shkak të vakumit ligjor të krijuar nga anulimi i udhëzimit 308, datë 22.05.2017 “Për funksionin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-ve” si dhe akteve ligjore e nënligjore për zbatimin e ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Mungesa e bazës ligjore pezulloi përkohësisht procesin e certifikimit të aplikantëve për shpsf-t, dhe qëllimi i cilësimit i “vlefshëm” ishte shmangia nga penaliteti i punonjësve të cilët sipas ligjit aktual paisen me certifikatat me afat 4 –vjeçar. Bazuar në nenin 5 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, afati i vlefshmërisë së certifikatave të punonjësve të shërbimit, shpsf, është 4 vjeçar nga momenti i certifikimit të tyre”.

III.5.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k., mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Vrana Security Group” sh.p.k., KPP konstaton se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomik duhet të paraqesin certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën sa është numri i punonjësve të shërbimit të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut përkatës në të cilin kryhet shërbimi i ruajtjes së objektit (në rastin konkret kërkohen 10 roje). Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Vrana Security Group” sh.p.k., konstatojmë se ky i fundit ka paraqitur një numër më të madh se 10 certifikata të punonjësve të shërbimit për ruajtjen dhe sigurinë fizike, lëshuar nga DVP Durrës, brenda afatit 4-vjeçar të vlefshmërisë të parashikuar në nenin 5, pika 5, të Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Pra, operatori ekonomik “Vrana Security Group” sh.p.k. ka dorëzuar më shumë se 10 certifikata të punonjësve të shërbimit për ruajtjen dhe sigurinë fizike që disponon, siç kërkohet në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor. Komisioni vëren se në asnjë dispozitë ligjore apo akt nënligjor nuk parashikohet se certifikatat për punonjës të shërbimit janë me afat të pacaktuar, përkundrazi për afatin e vlefshmërisë së tyre, pika 5 e nenit 5 të ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, parashikon se certifikatat lëshohen për një afat 4-vjeçar me të drejtë ripërtëritje. Edhe vetë Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, me tagrat e organit kompetent dhe përgjegjës për certifikimin e punonjësve të shërbimit të shoqërive shpsf, sqaron në kthimin e përgjigjes drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet shkresës me nr. 4039/1 prot., datë 27.04.2018, se afati i vlefshmërisë së certifikatave të punonjësve të shërbimit shpsf, është 4 vjeçar, nga momenti i certifikimit. APP dhe KPP rekomandojnë se, në rastet kur në dokumentat e tenderit do të



kërkohet paraqitja e certifikatave të punonjësve të të shërbimit, së bashku me këtë kriter, të kërkohet edhe paraqitja e një vërtetimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore, i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar, dhe vlefshmërinë e këtyre certifikatave, datën e certifikimit (datën e lëshimit), si dhe afatin e vlefshmërisë së kësaj certifikate.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shkresë nr. 11/1 Protokollit., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, *Lista e emërore e punonjësve të subjektit "Vrana Security Group" nënkategoria I.3.A.* me gjithësej 86 punonjës të certifikuar, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës nuk ka përcaktuar afat vlefshmërie të certifikatave të punonjësve të shërbimit të listuar në këtë shkresë (vërtetim), por ka pasqyruar datën e lëshimit të certifikatave, nga ku vërtetohet se operatori ekonomik disponon më shumë se 10 punonjës shërbim, të pajisur me certifikata të vlefshme, brenda afatit 4 vjeçar. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik "Vrana Security Group" sh.p.k., ka përmbushur kriterin e vendosuar nga autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, pasi ka paraqitur më shumë se 10 certifikata të vlefshme për punonjësit e shërbimit, sic kërkohet nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "Nazeri 200" shpk nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesat e operatorëve ekonomik "Nazeri 2000" shpk dhe "Vrana Security Group" shpk për procedurën e prokurimit "*Kërkesë për Propozime*", me objekt: "*Shërbim i Ruajtjes së Godinave me Roje Private*" – *Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*" me nr. REF-65350-04-26-2018, me fond limit 3,035,695 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.05.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës.
2. Të mos pranojë ankesat e operatorëve ekonomik "Eurogjici Security" shpk dhe "Toni Security" shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik "Eurogjici Security" shpk, dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këto operator ekonomikë.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë "Nazeri 2000" shpk, "Vrana Security Group shpk.

6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 1012 protokoli Datë 28.05.2018; Nr. 1018 protokoli Datë 30.05.2018;**

**Nr. 1036 protokoli Datë 01.06.2018; Nr. 1037 protokoli Datë 01.06.2018;**

**Nr. 1106 protokoli Datë 13.06.2018;**

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**

**Evis Shurdha**

